



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Ligji Nr. 2004/ 18**

**PËR TREGTINË E BRENDSHME**

Kuvendi i Kosovës,

Duke u bazuar në Rregullorën nr. 2001/9 të dt. 15 Maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, veqanërisht Kreu 5.1. (ç), 5.7, 9.1.1 dhe 9.1.26 (a) dhe

Me qëllim të promovimit të zhvillimit të një ekonomie të shëndoshë të tregut të lirë të brendshëm në Kosovë.

Nxjerr ligjin vijues:

**LIGJI PËR TREGTINË E BRENDSHME**

**PJESA E PARË**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Me këtë ligj rregullohen kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së tregtisë në tregun e brendshëm, tregtia me shumicë, tregtia me pakicë, ankandi, ndërmjetësimi në tregti, praktikat kufizuese dhe masat mbrojtëse për ushtrimin e veprimtarisë tregtare, konkurrencën e pandershme, masat mbikëqyrëse, masat administrative dispozitat ndëshkuese dhe dispozitat përfundimtare.

**Definicionet dhe kuptimi i termave**

**Neni 2**

Secili prej termave në vijim, kudo që përdoret në këtë ligj, do të ketë kuptimin e dhënë, përveç nëse konteksti brenda të cilit një term i tillë paraqitet nënkupton qartë diçka tjetër:

**“Praktikë mashtruese tregtare”** nënkupton shkatërrimin e çfarëdo prove materiale me qëllim të mashtrimit të konsumatorëve në lidhje me blerjen ose shitjen e mallrave në tregun e brendshëm.

“**Person fizik**” nënkupton individin dhe personin fizik si pronar i ndërmarrjes së regjistruar si biznes individual.

“**Person juridik**” nënkupton shoqërinë aksionere, partneritetet (shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe komandite), kompaninë e huaj ndërmarrjen shoqërore dhe ndërmarrjen publike.

“**Ministër**” nënkupton Ministrin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

“**Ministri**” nënkupton Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë të themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut.nr. 2001/19

“**Shitës apo furnizues**” nënkupton çdo person fizik apo juridik, i cili në kontratat e rregulluara nga ky Ligj vepron për qëllime që lidhen me tregtinë, biznesin apo profesionin e tij, publik apo privat.

“**Prodhues**” nënkupton prodhuesin e mallrave për konsumatorët, importuesin e mallrave për konsumatorët në territorin e Komunitetit ose çdo person tjetër që synon të jetë prodhues duke vendosur emrin, markën tregtare ose ndonjë shenjë tjetër të tij dalluese në mallrat për konsum.

“**Transaksione komerciale**” nënkupton transaksionet mes sipërmarrësve ose mes sipërmarrësve dhe autoriteve publike, të cilat bëjnë shpërndarjen e mallrave ose kryerjen e shërbimeve kundrejt pagesës (shpërblimit)

“**Tregtar**” nënkupton çdo person fizik apo juridik, i cili për transaksionin në fjalë vepron brenda cilësisë së tij tregtare ose profesionale dhe kushdo që vepron në emër apo për llogari të një tregtari.

“**Konsumator**” nënkupton çdo person fizik apo juridik, i cili në kontratat e rregulluara nga ky Ligj vepron për qëllime të ndryshme nga tregtia, biznesi apo profesioni i tij;

“**Produkt**” nënkupton çdo mall apo shërbim përfshi pasurinë e paluajtshme;

“**Praktika komerciale (tregtare)**” nënkupton çdo veprim, mosveprim, sjellje ose përfaqësim, komunikim tregtar, përfshi reklamimin dhe marketingun nga tregtari që lidhen direkt me promovimin, shitjen ose furnizimin e produkteve tek konsumatorët;

“**Çrregullim material i sjelljes ekonomike të konsumatorëve**” nënkupton përdorimin e një praktike tregtare për të keqndikuar dukshëm mbi aftësinë e konsumatorëve për të marrë një vendim të informuar duke i çuar konsumatorët drejt marrjes së një vendimi për një transaksion që në kushte të tjera nuk do ta kishin marrë.

“**Kodi i sjelljes**” nënkupton çdo marrëveshje që definon sjelljen e tregtarëve, të cilët marrin përsipër t’i nënshtrohen kodit në raport me një apo më shumë praktika tregtare ose sektorë të biznesit.

“**Pronar i kodit**” nënkupton çdo entitet, përfshi tregtarin apo grup tregtarësh që janë përgjegjës për formulimin dhe rishikimin e kodit të sjelljes dhe/ose për monitorimin e pajtueshmërisë me kodin nga ana e atyre që kanë marrë përsipër ta respektojnë atë.

“**Kujdes profesional**” nënkupton masat e aftësive dhe kujdesit të veçantë të treguar nga tregtari në proporcion me kërkesat e praktikave normale të tregut për konsumatorët në fushën e tij të aktivitetit në tregun e brendshëm.

“**Ftesë për blerje**” nënkupton një komunikim tregtar, i cili tregon karakteristikat kryesore të produktit dhe çmimin sipas një mënyre të përshtatshme të komunikimit tregtar dhe i lejon konsumatorëve të bëjnë blerjen.

”**Influenca e padrejtë**” nënkupton shfrytëzimin e një pozicioni pushteti për ushtruar presion, pa përdorur forcë fizike, në një mënyrë të tillë që kufizon dukshëm aftësinë e konsumatorit për të marrë një vendim të bazuar në informata.

### Neni 3

3.1. Tregu i brendshëm në Kosovë është unik dhe rregullohet me ligjet e Kosovës.

3.2 Të gjithë personat që ushtrojnë veprimtari komerciale trajtohen pa dallime, diskriminime ose privilegje dhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

### Neni 4

Tregtari ushtron të gjitha aktivitetet e lejuara nga ligji.

### Neni 5

5.1. Ndalohet konkurrenca jolojale nga ana e tregtarëve sipas nenit 31.

5.2. Organet qendrore dhe lokale, me aktet e tyre nuk mund që me ligj apo me ndonjë rregullim tjetër të kufizojnë të drejtën e pjesëmarrjes në treg, të ndalojnë konkurrencën e lirë në treg ose të krijojnë pozitë të pabarabartë në treg për tregtarë dhe konsumatorë të caktuar, përveçse në rastet e parashikuara me ligj.

## PJESA E DYTË USHTRIMI I AKTIVITETIT TREGTAR

### Neni 6

Tregtari mund të ushtrojë të gjitha llojet e veprimtarisë tregtare për të cilat është i regjistruar, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligjet apo dispozitat e tjera të aplikueshme.

### Neni 7

Para regjistrimit, tregtari mund të ushtrojë ato aktivitete tregtare që janë të nevojshme për efekt të regjistrimit.

### Neni 8

8.1. Pa paragjykuar nenin 3.2, ky ligj mbulon aktivitetet e mëposhtme:

- a. ndërrmarjet publike dhe iniciativat civile që shesin mallra të caktuar me qëllim përmbushjen e detyrave të tyre në pajtim me aktet e tyre (statutet),

- b. personat fizikë dhe juridikë që janë të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë prodhuese, kur prodhimet e tyre i plasojnë në treg,
- c. ndërmarrjet publike, iniciativat qytetare të cilat për realizimin e detyrave të tyre, në përputhje me aktet e tyre (me statutin e tyre), shesin mallin e caktuar,
- d. personat fizik, të cilët merren me prodhimtari bujqësore, kur prodhimet e tyre i plasojnë në treg,
- e. personat fizik të cilët në bazë të kontratës me tregtarin e regjistruar, pa themelimin e marrëdhënies së punës, ushtrojnë tregtinë me pakicë për llogari të tregtarit.

8.2. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përcakton me rregullore aktivitetet e mbuluara nga neni 8.1.

#### Tregtia me shumicë Neni 9

Shitësi me shumicë është një ndërmjetës në zinxhirin shpërndarës që blen produktin në sasi të madhe nga prodhuesi dhe ia shet në masë më të vogël shpërndarësit apo shitësit me pakicë.

#### Neni 10

10.1. Tregtia me shumicë ushtrohet në objekte të veçanta ose depo për shitjen me shumicë, në tregje për shitje me shumicë, lokacione të tjera që i plotësojnë kushtet e paparapra dhe në tranzit.

10.2. Me tregtinë me shumicë në tranzit nënkuptohet blerja dhe shitja e mallit pa u vendosur dhe mbajtur në depo të shitjes me shumicë.

#### Neni 11

11.1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë rregullon me Udhëzim për Administrativ ushtrimin e veprimtarisë së tregtisë me shumicë në objekte të veçanta apo depo.

11.2. Udhëzimi Administrativ sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të përcaktojë kushtet e posaçme për objektet dhe depot, si dhe kushtet për deponimin e mallrave për të siguruar mbrojtjes e jetës, shëndetit dhe mjedisit.

#### Neni 12

12.1. Tregtia me shumicë mund të kryhet edhe në bursa të mallit, panaire, ekspozita dhe ankande.

12.2. Themelimi dhe veprimtaria e bursave, panaireve dhe formave të ngjashme rregullohet me ligj të posaçëm.

Tregtia me pakicë  
Neni 13

Tregtia me pakicë nënkupton blerjen e mallit nga tregtari me shumicë, me qëllim të shitjes së tij tek konsumatori i fundit.

Neni 14

Tregtia me pakicë ushtrohet në objektet tregtare (në tekstin e mëtejshëm: shitore) dhe jashtë tyre, nëse për një mënyrë të tillë të shitjes janë plotësuar kushtet e caktuara.

Neni 15

15.1. Shitje e mallit jashtë shitoreve konsiderohet shitja në tregjet me pakicë, përfshi shitjen përmes postës, në standë, kioskë, në objektet blerëse, përmes automatit, përmes masmediave dhe shitja në lëvizje (shitësit rrugor).

15.2. Shitja e mallit jashtë shitores si shitje e rastit në: panaire, ekspozita, manifestime dhe të ngjashme, konsiderohet gjithashtu shitje me pakicë.

15.3. Shitja e mallit jashtë tregut: në stenda, kioska, automate, shitja në lëvizje ose shitja e rastit duhet të kryhet në vendet paraprakisht të përcaktuara nga autoritetet përkatëse.

Neni 16

16.1. Vetëm ata tregtarë që kanë një licencë të vlefshme mund të ushtrojnë veprimtari tregtare si dhe të sheshin prodhime.

16.2. Personat fizik, të cilët merren me prodhimtari bujqësore, prodhimet e tyre mund t'i sheshin lirisht në pajtim me dispozitat e posaçme, duke mos patur nevojë të regjistrohen.

16.3. Inspektori i tregut mund t'ua ndalojë tregtimin personave fizikë dhe juridikë pas dhënies së njoftimit të nevojshëm.

Ankandet  
Neni 17

17.1. Ankandi është formë e veçantë e ushtrimit të tregtisë me shumicë dhe pakicë.

17.2. Ankandi është shitja e organizuar e mallit ofertuesit të ofertës më të lartë në bazë të ankandit të shpallur publik në vend dhe kohë të caktuar.

17.3. Ankandet mund të jenë të përhershme dhe të përkohshme.

17.4. Kushtet për organizimin e ankandit, regjistrimin e mallit që shitet në ankande, mënyrën e afarizmit dhe procedurën e shitjes përmes ankandit e përcakton me rregullore Ministri i Industrisë dhe Tregtisë.

Ndërmjetësimi në tregti  
Neni 18

18.1. Për qëllime të këtij ligji "agjent tregtar" nënkupton një ndërmjetës të vetëpunësuar, i cili ka autoritet të vazhdueshëm për të negociuar shitjen ose blerjen e mallrave për llogari të një personi tjetër i quajtur më poshtë "urdhërdhënësi", apo të negociojë dhe përfundojë transaksione të tilla në llogari dhe emër të urdhërdhënësit .

18.2. Agjenti tregtar në kuptim të këtij ligji nuk nënkupton në mënyrë të veçantë:

- a. personin që në cilësinë e tij si zyrtar, ka fuqinë të marrë angazhime të detyrueshme për një shoqëri apo shoqatë,
- b. ortakun, i cili është ligjërisht i autorizuar të marrë angazhime të detyrueshme për ortakët e tij,
- c. marrësin, marrësin dhe menaxherin, likujdatorin apo administruesin e besuar në procedurat e falimentimit.

Neni 19

Ky ligj nuk aplikohet për:

- a. agjentët tregtar aktivitetet e të cilëve janë pa pagesë
- b. agjentët tregtar kur veprojnë në bursë apo në treg.

Të drejtat dhe detyrimet  
Neni 20

20.1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve një agjent tregtar duhet të kujdeset për interesat e urdhërdhënësit të tij dhe të veprojë me devotshmëri dhe mirëbesim.

20.2. Veçanërisht një agjent tregtar duhet:

- a. të bëjë përpjekjet e duhura për të negociuar dhe kur është e nevojshme të përfundojë transaksionet sipas instruksioneve që ka marrë;
- b. t'i komunikojë urdhërdhënësit të gjithë informacionin e nevojshëm për të cilin ka dijeni;
- c. të përmbush instruksionet e arsyeshme që ka marrë nga principlali i tij.

Neni 21

21.1. Në mardhëniet e tij me agjentin tregtar, urdhërdhënësi duhet të veprojë me devotshmëri dhe mirëbesim

21.2. Urdhërdhënësi veçanërisht duhet:

- a. t'i sigurojë agjentit tregtar dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me mallrat në fjalë;
- b. të sigurojë për agjentin e tij tregtar informacionin e nevojshëm për kryerjen e kontratës së agjencisë dhe në veçanti të njoftojë agjentin tregtar brenda një kohe

të arsyeshme kur parashikon që volumi i transaksioneve tregtare do të ulet dukshëm në krahasim me atë që normalisht ka pritur agjenti.

21.3. Urdhërdhënësi për më tepër duhet të informojë agjentin tregtar brenda një kohe të arsyeshme për pranimin, refuzimin dhe mosekszekutimin nga ana e tij të një transaksioni tregtar që agjenti tregtar e ka kryer për urdhërdhënësin.

#### Neni 22

Palët nuk mund të shmangen nga dispozitat e nenit 20 dhe 21.

#### Neni 23

23.1. Në mungesë të ndonjë marrëveshjeje mbi këtë çështje midis palëve, një agjent tregtar ka të drejtën e shpërblimit që agjentët tregtarë të caktuar për mallrat që janë objekti i kontratës së agjencisë përfitojnë zakonisht në vendin ku ai kryen aktivitetet e tij. Nëse nuk ka ndonjë praktikë të tillë zakonore, agjenti tregtar ka të drejtën për një shpërblim të arsyeshëm duke marrën në konsideratë të gjitha aspektet e transaksionit.

23.2. Çdo shpërblim, i cili ndryshon brenda vlerës së transaksioneve të biznesit konsiderohet si komision në kuptim të këtij ligji.

23.3. Nenet 18 deri në 23 nuk zbatohen nëse agjenti tregtar nuk shpërblehet tërësisht apo pjesërisht me komision.

#### Neni 24

24.1. Agjenti tregtar ka të drejtën të mbajë komisionin për transaksionet komerciale të përfunduara gjatë periudhës së rregulluar nga kontrata e agjencisë:

- a. nëse transaksioni ka përfunduar si rezultat i veprimit të tij; ose
- b. nëse transaksioni është përfunduar me një palë të tretë, të cilin më parë e ka fituar si klient për transaksionet e ngjashme.

24.2. Agjenti tregtar ka gjithashtu të drejtën të mbajë komisionin për transaksionet komerciale të përfunduara gjatë periudhës së rregulluar nga kontrata e agjencisë:

- a. -ose kur i është besuar një zonë gjeografike ose një grup klientësh,
- b. -ose kur ka një të drejtë ekskluzive për një zonë gjeografike ose një grup klientësh dhe kur transaksioni është kryer me klientin që i përket kësaj zone apo grupi.

#### Neni 25

Agjenti tregtar ka të drejtën të mbajë komisionin për transaksionet komerciale të përfunduara pas mbarimit të kontratës së agjencisë:

- a. nëse transaksioni i atribuohet kryesisht përpjekjeve të agjentit tregtar gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata e agjencisë dhe

- b. nëse transaksioni është kryer brenda një periudhe të arsyeshme pasi ajo kontratë ka përfunduar; ose
- c. nëse në pajtim me kushtet e nenit 24, urdhëri i palës së tretë ka mbërritur tek urdhërdhënësi ose tek agjenti kryesor para përfundimit të kontratës.

#### Neni 26

Agjenti tregtar nuk ka të drejtën e komisionit sipas nenit 24, nëse ai komision është i pagueshëm sipas nenit 25 për agjentin e mëparshëm tregtar, përveçse nëse që për shkak të rrethanave është e arsyeshme që komisioni të ndahet midis agjentëve komercialë.

#### Neni 27

27.1. Komisioni duhet të bëhet i pagueshëm sa më shpejt dhe në masën që kushtet e mëposhtme ekzistojnë:

- a. urdhërdhënësi ka kryer transaksionin; ose
- b. urdhërdhënësi sipas marrëveshjes me palën e tretë duhet ta ketë kryer transaksionin; ose
- c. pala e tretë e ka kryer transaksionin.

27.2. Komisioni duhet të bëhet i pagueshëm më së largu kur pala e tretë e ka kryer ose duhet ta kish kryer pjesën e saj të transaksionit, nëse urdhërdhënësi e ka kryer pjesën e tij të transaksionit ashtu siç duhej.

27.3. Komisioni duhet të paguhet jo më vonë sesa dita e fundit e muajit që vjen pas tremujorit në të cilin ai është bërë i pagueshëm.

27.4. Marrëveshjet për heqje dorë nga paragrafët 2 dhe 3 në dëm të agjentit tregtar nuk janë të lejueshme.

#### Neni 28

28.1. E drejta e komisionit mund të shuhet vetëm nëse dhe në masën që:

- a. është vendosur që kontrata mes palës së tretë dhe principalit nuk do të ekzekutohet, dhe
- b. kjo situatë ka ndodhur për shkak të një arsyeje për të cilën nuk ka faj principalin.

28.2. Çdo komision që agjenti tregtar ka marrë më parë rimbursohet nëse e drejta mbi të ka pushuar.

28.3. Marrëveshjet për heqje dorë nga paragrafi 1 në dëm të agjentit tregtar nuk janë të lejueshme.



Shitjet në distancë  
Neni 29

29.1. Për qëllime të këtij ligji “kontratë në distancë” nënkupton çdo kontratë për mallra apo shërbime që lidhet mes furnizuesit dhe konsumatorit sipas një skeme të organizuar për shitjen apo kryerjen e shërbimeve në distancë, e drejtuar nga furnizuesi, i cili për qëllimin e kontratës përdor ekskluzivisht një apo disa mjete të komunikimit në distancë deri dhe përfshi momentin kur kontrata është përfunduar.

29.2. “Mjete të komunikimit në distancë” nënkuptojnë çdo mjet, i cili pa prezencën fizike të njëkohshme të furnizuesit dhe konsumatorit mund të përdoret për përfundimin e një kontrate mes këtyre palëve.

29.3. ‘Operator i mjeteve të komunikimit’ nënkupton çdo person fizik apo juridik, publik apo privat, tregtia, biznesi apo profesioni, i të cilit përfshin vënien në dispozicion të furnizuesve të një apo më shumë mjeteve të komunikimit në distancë

Përfundime  
Neni 30

Kjo pjesë e ligjit nuk aplikohet për kontratat:

- a. që kanë lidhje me shërbimet financiare;
- b. të përfunduara me anë të makinave automatike të shitjes, ose objekte të automatizuara komerciale;
- c. të përfunduara me anë të operatorëve të telekomunikacionit në telefonat në kabinat publike;
- d. të përfunduar për ndërtimin dhe shitjen e pasurisë së paluajtshme ose në lidhje me të drejtat mbi pasurinë e paluajtshme, përveç qirasë;
- e. të përfunduara me ankand;
- f. kontrata për furnizimin e ushqimeve, pijeve ose të mallrave të tjera për konsum të përditshëm, të dërguara në shtëpinë e konsumatorit, në residencën apo vendin e punës me anë të personit të ngarkuar për shpërndarjen;
- g. kontratat për sigurimin e akomodimit, transportit, ushqimit apo të shërbimeve të kohës së lirë, ku furnizuesi merr përsipër kur lidhet kontrata që t’i ofrojë shërbimet në një datë specifike ose brenda një kohe specifike.

Kufizimet në përdorimin e mjeteve të komunikimit në distancë  
Neni 31

Për përdorimin nga ana e furnizuesit të mjeteve të mëposhtme nevojitet konsensusi paraprak i konsumatorit:

- a. sistemi automatik i thirrjes (telefonimit) pa ndërhyrjen e njeriut (makina automatike e thirrjeve),
- b. paisja për dërgimin e faksit.

Shitja në derë (tek porta)  
Neni 32

32.1. Ky ligj aplikohet për kontratat sipas të cilave një tregtar furnizon mallra ose shërbime tek konsumatori dhe të cilat realizohen gjatë një ekskursioni të organizuar nga tregtari larg lokalit të tij të biznesit, ose gjatë një vizite të tregtarit:

- a. në shtëpinë e konsumatorit ose të ndonjë konsumatori tjetër;
- b. në vendin e punës së konsumatorit; kur vizita nuk ndodh për shkak të kërkesës së shprehur të konsumatorit.

32.2. Ky ligj aplikohet edhe për kontratat e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve përveç atyre për të cilat konsumatori ka kërkuar vizitën e tregtarit, me kusht që kur ai ka kërkuar vizitën, konsumatori nuk e dinte, ose nuk mund ta dinte në kushte të arsyeshme që furnizimi i këtyre mallrave e shërbimeve të tjera ishte pjesë e aktivitetit tregtar ose profesional të tregtarit.

32.3. Ky ligj aplikohet për kontratat në lidhje me të cilat është bërë një ofertë nga konsumatori sipas kushteve të përshkruara në paragrafët 1 ose 2 megjithëse konsumatori nuk ishte i detyruar nga ajo ofertë përpara pranimit të saj nga tregtari.

32.4. Ky ligj aplikohet për ofertat kontraktuale të bëra nga konsumatori sipas kushteve të ngjashme me ato të përshkruara në paragrafët 1 ose 2 ku konsumatori është i detyruar nga oferta e tij.

Neni 33

Në rast të transaksioneve brenda fushës së veprimit të nenit 32, tregtarëve do t'u kërkohej t'iu japin konsumatorëve njoftim me shkrim për të drejtën e tyre të anulimit brenda periudhës së parashikuar në nenin 34, së bashku me emrin dhe adresën e personit, kundër të cilit kjo e drejtë mund të ushtrohet. Ky njoftim përmban datën dhe përcakton detajet që mundësojnë identifikimin e kontratës dhe i jepet konsumatorit:

- a. në rastin e nenit 32.1 në kohën përfundimit të kontratës;
- b. në rastin e nenit 32.3 jo më vonë sesa koha e përfundimit të kontratës;
- c. në rastin e nenit 32.1 dhe 32.4 kur bëhet oferta nga konsumatori.

Neni 34

34.1. Konsumatori ka të drejtë të tërheqë efektet e angazhimit të tij duke dërguar një njoftim brenda një kohe jo më të vogël se 7 ditë nga marrja nga konsumatori e lajmërimit të përmendur në nenin 4 në pajtim me procedurën e përshkruar në ligjin e vendit. Është i mjaftueshëm fakti që lajmërimi të dërgohet para mbarimit të kësaj periudhe.

34.2. Dhënia e njoftimit ka efektin e lirimit të konsumatorit nga çdo obligim sipas kontratës së anuluar.

Neni 35

Konsumatori nuk mund të heqë dorë nga të drejtat që i takojnë me këtë ligj

## Neni 36

Nëse konsumatori ushtron të drejtën e tij të heqjes dorë , efektet ligjore të dorëheqjes rregullohen nga ligjet e vendit, sidomos ato në lidhje me rimbursimin e pagesave për mallrat dhe shërbimet e siguruar dhe kthimin e mallrave të marra.

## Neni 37

Ky ligj nuk i ndalon dispozitat e tjera që të adaptojnë apo krijojnë dispozita më të favorshme për mbrojtjen e konsumatorëve në fushën që ai mbulon.

## Kushtet për ushtrimin e veprimtarisë tregtare Neni 38

38.1. Për ushtrimin e veprimtarisë tregtare Ministria e Tregtisë dhe Industrisë rregullon me Udhëzim Administrativ:

- a. kushtet minimale teknike, të cilat duhet të përmbushin lokalet afariste, paisjet dhe mjetetet me ndihmën e të cilave ushtrohet veprimtaria tregtare si dhe kushte të tjera, varësisht nga forma dhe mënyra e ushtrimit të veprimtarisë tregtare,
- b. kushtet e përgjithshme shëndetësore dhe sanitare, të cilat duhet t'i përmbushë lokali afarist ku kryhet tregtia, kushtet që duhen plotësuar nëse tregtia kryhet jashtë dhe standardet e higjenës që duhen plotësuar nga personeli që kryen aktivitet tregtar.

38.2. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë rregullon me Udhëzim Administrativ ato produkte që mund të shiten vetëm në vende të caktuara dhe/ose informacionin e detajuar që duhet të kenë për vendin dhe datën e prodhimit, datën e fundit në të cilën duhen konsumuar dhe detajet në lidhje me përmbajtjen dhe peshën.

38.3. Lejën e punës pas plotësimit të kushteve nga neni 38.1 e lëshon organi kompetent komunal.

38.4. Leja e punës është e përherëshme.

38.5. Tarifat e taksës për leje pune janë unike në tërë Kosovën dhe paraqesin të hyra në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

38.6. Nëse përkunder plotësimit të kushteve, pronarit nuk i lëshohet leja nga organi kompetent komunal, Inspektori i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë mund të urdhërojë dhënien e lejes për punë.

38.7. Në rast kur edhe pas urdhërit të Inspektorit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nuk lëshohet leja epunës, ky i fundit lëshon lejen e vlefshme të punës.

38.8. Ankesa në urdhërin e Inspektoratit nuk e ndalon ekzekutimin.

## Neni 39

39.1. Personat, të cilët kryejnë punë të caktuara në tregti duhet t'i plotësojnë kushtet minimale profesionale për kryerjen e tyre.

39.2. Kushtete minimale sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe përgaditjen shkollore e përcakton Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

## Neni 40

Orarin e punës, përcaktimin e orarit ditor dhe javor të shitoreve dhe objekteve të tjera, orarin e punës gjatë ditëve të festave dhe fundjavës, për të cilat shitësi detyrohet të punojë, orarin e punës për tregje, panairë dhe ekspozitat e karakterit lokal dhe formave të tjera të ushtrimit të veprimtarisë tregtare e përcakton administrata locale në pajtim me dispozitat që i nxjerr Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

## Neni 41

41.1. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, tregtari me shumicë, është i detyruar që në çdo objekt të shitjes apo në depo të mbajë evidencë lidhur me regjistrimin, blerjen, shitjen, çmimet, ndërmjetësimin tregtar, çertifikatën e regjistrimit dhe lejen për punë.

41.2. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, tregtari me pakicë është i obliguar që në çdo shitore në vend të caktuar të mbajë evidencë lidhur me regjistrimin, blerjen, shitjen, çmimet, ndërmjetësimin tregtar, çertifikatën dhe lejet për punë.

41.3. Ministri rregullon me Udhëzim Administrativ formën, përmbajtjen dhe mënyrën e evidencën e librave (të kontabilitetit) të biznesit dhe hedhjen e të dhënave në bazë ditore, si dhe rregjistrimet (apo inventarin vjetori) të aseteve dhe borxheve të biznesit.

## Kufizimet për ushtrimin e veprimtarisë tregtare

### Neni 42

42.1. Qeveria me akt të veçantë, përkohësisht, mund të kufizojë ushtrimin e veprimtarisë tregtare në rastet:

- a. e fatkeqësive elementare dhe natyrore, kur ndodh apo mund të ndodhin çrregullime në treg, çrregullime në furnizimin e popullatës ose çrregullime në rajon, të cilat rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve,
- b. e çrregullimeve të konsiderueshme në tregun e brendshëm si mungesa e mallrave reproduktuese për prodhimtari, përpunim dhe për sigurimim e jetës së qytetarëve,
- c. e gjendjes së luftës ose rrezikut nga lufta,
- d. kur rrezikohet furnizimi me lëndë së parë apo materiali me rëndësi strategjike.

42.2. Qeveria përcakton kufizimet e ushtrimit të veprimtarisë së tregtisë nga paragrafi 1 i këtij neni vetëm nëse çrregullimet nuk mund të evitohen me masa të tjera ose nevojat nuk mund të përmbushen nga rezervat e mallit, importi ose me masa tjera të politikës ekonomike.

## Neni 43

Në rastet nga neni 40 i këtij Ligji, Qeveria mund të përcaktojë:

- a. kufizimin e tregtisë ose kufizimin e mallrave të caktuara ose kushtet e veçanta për tregti me mallra të caktuara,
- b. kufizimin e eksportit të mallrave të caktuar ose kushtet e veçanta për eksport për mallra të caktuara,
- c. t'i ndalojë tregtarit shitjen e mallit të caktuar,
- d. obligimin e tregtarit për furnizim dhe shitje të llojit dhe sasisë së caktuar të mallit si dhe shitjen e mallit konsumtorëve të caktuar sipas renditjes së përcaktuar të prioritetit,
- e. obligimin e disa tregtarëve për ruajtjen e llojit dhe sasisë së caktuar të mallrave.

## Konkurenca jolojale

### Neni 44

44.1. Me konkurrencë jolojale nënkuptohen veprimet e tregtarëve me të cilat në konkurrencën e tregut çënohet praktika e mirë afariste. Në transaksionet me natyrë komerciale, industriale apo bujqësore të gjitha aktet që lidhen me konkurrencën, por që janë në konflikt me praktikën e mira tregtare janë të ndaluara.

44.2. Konkurenca jolojale sipas nenit 42 është e ndaluar.

### Neni 45

Në konkurrencë jolojale sipas nenit 42 nënkuptohet veçanërisht:

- a. reklamimi, shpallja ose oferta e mallit dhe shërbimeve duke përdorur të dhëna ose shprehje të cilat ndikojnë padrejtësisht mbi biznesin e një tregtari tjetër, duke shfrytëzuar emrin e tregtarit tjetër ose prodhimet apo shërbimeve të tij,
- b. reklamimi, shpallja ose oferta e mallit dhe shërbimeve me të cilat fyhet ose nënçmohet tregtari tjetër në baza nacionale, racore, politike dhe fetare,
- c. ofrimi i të dhënave apo përhapja e thashethemeve për tregtarin tjetër, nëse ato të dhëna dëmtojnë ose mund të sjellin dëm imazhit ose afarizmit të tregtarit tjetër, përveç rasteve kur informacioni është i vertetë,
- d. shitja e mallit me shenja dhe të dhëna, të cilat krijojnë ose mund të krijojnë konfuzion lidhur me prejardhjen, prodhimtarinë, sasinë, cilësinë ose karakteristikat e tjera të mallit,
- e. fshehja e mangësive ose gabimeve të mallit dhe shërbimeve ose shkaktimi i hutive të tjera tek konsumatorët,
- f. veprimet e tregtarit të drejtuara në ndërprerjen e marrëdhënjeve afariste në mes tregtarëve të tjerë, ose pamundësimi apo vështirësimi i marrëdhënieve afariste midis tregtarëve,

- g. mospërbushja e paarsyeshme ose ndëprejra e kontratës me tregtarë të caktuar me qëllim që të lidhet kontratë e njëjtë ose më e favorshme me tregtarin tjetër,
- h. kontrata e eksportit të mallit dhe shërbimeve me çmim më të ulët, në kohën kur tregtari tjetër e ka lidhur kontratën për të njëjtin mall dhe shërbim me çmim më të lartë dhe me këtë rast i krijohet dëm këtij tregtari,
- i. përdorimi i paautorizuar i emrit, firmës, markës ose shenjave tjera të tregtarit tjetër,
- j. bërja publike e deklaratave jo të sakta në lidhje me cilësinë, origjinën, mjetet e prodhimit, çmimet e mallit, burimin e furnizimit, rekomandimin (reklamimin) e mallrave, arsyeja e shitjes ose sasia e mallit, të cilat mund të krijojnë përshtypje të rremë të një oferte të favorshme për konsumatorët,
- k. dhënia ose premtimi i dhuratave, përfitimit material ose përfitimeve të tjera për tregtarin tjetër, punëtorin e tij ose personin i cili punon për tregtarin, nëse dhënësit i jepet një përparësi kundrejt tregtarëve të tjerë,
- l. përdorimi i paautorizuar i shërbimeve të agjentit tregtar, përfaqësuesit tregtar, ose përfaqësuesit të tregtarit tjetër,
- m. përvetësimi i blerësit të mallit ose shfrytëzuesit të shërbimeve duke dhënë ose premtuar shpërblime ose përfitime tjera materiale të cilat sipas vlerës së tyre tejkalojnë vlerën reale të mallrave dhe shërbimeve,
- n. përvetësimi kundërligjor i fshehtësirave afariste të tregtarit tjetër nga ana e një tregtari, punëtorëve, apo personave që trajnohen nga ky tregtar, me qëllim të përfitimit të një avantazhi nga tregtari tjetër ose çdo keqpërdorim i fshehtësisë së besuar afariste të tregtarit tjetër.

#### Neni 46

- 46.1. Ky ligj aplikohet për praktikën e padrejta tregtare sipas definimit të mëposhtëm në nenin 47, para dhe pas transaksionit tregtar në raport me ndonjë produkt.
- 46.2. Ky ligj nuk paragjykon rregullat për vlefshmërinë, formimin dhe efektet e kontratës.
- 46.3. Ky ligj nuk paragjykon përcaktimin e llojeve të dëmeve që mund të vijnë nga praktikën e padrejta tregtare dhe përcaktimi sasior i tyre.

#### Praktikat e padrejta tregtare

#### Neni 47

- 47.1. Praktikën e padrejta tregtare janë të ndaluara
- 47.2. Një praktikë tregtare do të konsiderohet si e pandershme nëse është në kundërshtim me kërkesat e kujdesit profesional dhe materialisht çrregullon ose ka mundësi të çrregulloj sjelljen ekonomike në lidhje me produktin që mbërrin apo që i është adresuar konsumatorit mesatar, apo anëtarit mesatar të një grupi, në rast se praktika tregtare i drejtohet veçanërisht një grupi konsumatorësh.
- 47.3. Në veçanti, praktikën tregtare quhen të padrejta nëse janë keqdrejtuese ose agresive sipas definicioneve të dhëna më poshtë në ligj.

Veprimet keqdrejtuese  
Neni 48

48.1. Një praktikë tregtare konsiderohet keqdrejtuese, nëse në ndonjë mënyrë, përfshi prezantimin, shkakton ose ka mundësi t'i shkaktojë konsumatorit mesatat marrjen e një vendimi për një transaksion që ai nuk do ta kish marrë në kushte të tjera, sepse e mashtron apo ka mundësi ta mashtrrojë në lidhje me:

- a. karakteristikat kryesore të produktit si gjindshmëria e tij, benefitet, risqet, ekzekutimi, përbërja, aksesorët, asistanca e konsumatorit pas blerjes dhe trajtimi i ankesave, metoda dhe data e prodhimit ose furnizimit, shpërndarja, përmeshja e qëllimit ose rezultatet dhe karakteristikat materiale të testeve ose provave të kryera mbi produktin;
- b. ndonjë deklaratë ose simbol në lidhje me sponsorizimin direkt apo indirekt ose aprovimin e tregtarit ose produktit;
- c. çmimi ose mënyra e llogaritjes së çmimit ose ekzistenca e avantazheve specifike në çmim (nevoja për një shërbim, pjesë, zëvendësim apo riparim);
- d. natyra, atributet dhe të drejtat e tregtarit ose agjentit të tij si identiteti i tij dhe asetet, kualifikimet e tij, statusi, aprovimi, shoqërimi apo lidhja, pronësia e të drejtave industriale, tregtare ose intelektuale ose titujt dhe vlerësimet e tij;
- e. pretendime për produktin që tregtari nuk mund t'i mbështes;
- f. të drejtat e konsumatorit ose rreziqet që ai mund të ndesh.

48.2. Një praktikë komerciale nuk do të konsiderohet si keqdrejtuese nëse, në kontekstin faktik, duke marrë në konsideratë të gjitha karakteristikat dhe kushtet, e drejton ose ka mundësi ta drejtojë konsumatorin mesatar të marrë në vendim për një transaksion që nuk do ta kishte marrë në kushte të tjera dhe përfshin:

- a. çdo marketing të produktit përfshi reklamimin e krahasuar, i cili krijon konfuzion me ndonjë produkt, markë tregtare, emër tregtar dhe shenja të tjera të dallueshme të një konkurrenti;
- b. mospajtimi nga ana e tregtarit me angazhimet e kodit të sjelljes që tregtari ka pranuar të respektojë nëse:
  - i angazhimi është i qendrueshëm dhe është në gjendje për t'u verifikuar,
  - ii informacioni që kategorizon tregtarët mbi të cilët aplikohet kodi dhe përmbajtja e kodit janë publike;
  - iii mospajtueshmëri me një angazhim të dhënë një autoriteti publik për të ndaluar praktikën e konkurrencës së padrejtë sipas këtij ligji.

Mosveprime keqdrejtuese  
Neni 49

49.1. Një praktikë komerciale konsiderohet si keqdrejtuese nëse në kuptimin faktik, duke marrë parasysh karakteristikat dhe rrethanat e saj, nuk jep informacionin që një konsumator mesatar ka konkretisht nevojë për të marrë një vendim të mbështetur në

informata në lidhje me një transaksion, prandaj shkaton ose ka mundësi t'i shkaktojë konsumatorit mesatar marrjen e një vendimi për një transaksion që nuk do ta kishte marrë në kushte të tjera.

49.2. Konsiderohet si keqdrejtues ai mosveprim kur tregtari fsheh ose e jep informacionin në një mënyrë të paqartë, jo interligjente, të pakuptueshme ose jo në kohën e duhur ose nuk arriin të identifikojë qëllimin e praktikës tregtare.

49.3. Për praktikën tregtare para transaksionit tregtar një mosveprim keqndikues mund të ndodh vetën nëse tregtari bën një ftesë për blerje. Në rastin e ftesës për blerje, informacioni i mëposhtëm konsiderohet si material, nëse kjo nuk është që më parë e kuptueshme nga konteksti:

- a. karakteristikat kryesore të produktit;
- b. emri komercial i tregtarit dhe kur është e aplikueshme, emri komercial i tregtarit në emër të të cilit ai është duke vepruar;
- c. çmimin përfshi tatimet dhe taksat, si dhe nëse është e përshtatshme, ngarkesat shtesë, pagesat për furnizim apo transport ose nëse këto pagesa nuk mund të llogariten paraprakisht në mënyrë të arsyeshme, faktin që pagesa shtesë mund të kërkohen;
- d. rregullimet në lidhje me pagesën, furnizimin, kryerjen e detyrimit dhe politikat e trajtimit të ankesave, nëse ato ndryshojnë nga kërkesat e kujdesit profesional;
- e. për produktet dhe transaksionet që përfshijnë të drejtën e tërheqjes ose anulimit të kësaj të drejte.

#### Praktikat agresive tregtare Neni 50

50.1. Një praktikë tregtare konsiderohet agresive nëse në kontekstin konkret, duke marrë parasysh gjithë karakteristikat dhe rrethanat, me anë të presionit, forcës, influencës së padrejtë, cënon dukshëm ose ka mundësi të cënojë dukshëm lirinë e zgjedhjes ose sjelljes të një konsumatori mesatar në lidhje me produktin dhe si rrjedhim e drejton atë, ose ka mundësi ta drejtojë në marrjen e një vendimi për një transaksion që nuk do ta kishte marrë në kushte të tjera.

50.2. Në përcaktimin nëse një praktikë tregtare përdor presionin, forcën apo influencën e padrejtë, merret në konsideratë:

- a. koha, natyra ose këmbëngulja;
- b. përdorimi i kërcënimeve ose gjuhës apo sjelljes abuzive;
- c. përdorimi nga ana e tregtarit e çdo fatkeqësie specifike apo rrethane të rëndë që cënon gjykimin e konsumatorit, për të cilin tregtari ka dijeni, për të influencuar vendimin e konsumatorit në lidhje me produktin;
- d. çdo barrierë jashtë kontraktuale e madhe ose disproporcionale e vendosur nga tregtari në rast se konsumatori dëshiron të ekzekutojë të drejtat e tij sipas kontratës, përfshi të drejtat për të mbaruar kontratën apo për të zgjedhur një produkt apo tregtar tjetër.
- e. çdo kërcënim për të kryer ndonjë veprim që nuk mund të kryehet ligjërisht.



## Neni 51

51.1. Dëmi i shkaktuar me anë të veprimeve të ndaluara të konkurrencës jolojale, praktikave të padrejta tregtare dhe praktikave keqdrejtuese kompensohet në procedurë gjyqësore.

51.2. Padinë sipas paragrafit 1 të këtij neni mund ta ngrejë tregtari i dëmtuar, Oda Ekonomike dhe format tjera të bashkimeve të tregtarëve.

51.3. E drejta në padi nga paragrafi 1 i këtij neni, parashkruhet në afat prej një viti nga dita kur paditësi është njoftuar për veprën dhe kryesin, e më së voni tri vite nga dita e kryerjes së veprës.

## PJESA E TRETË MBIKQYRJA DHE MASAT ADMINISTRATIVE

### Neni 52

Mbikëqyrjen në implementimin e dispozitave të këtij ligji e ushtron Inspektoriati Qëndror, inspeksionet e tjera dhe shërbimet doganore në pajtueshmëri me autorizimet e përcaktuara me ligje të veçanta.

### Neni 53

53.1. Nëse inspektori i autorizuar konstaton se aktiviteti tregtar nuk ishte i regjistruar ose nuk kishte leje pune, ai/ajo mund të ndalojë përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë tregtare deri në eliminimin e këtyre parregullive:

53.2. Ankesa kundër vendimit nuk e ndalon ekzekutimin e tij

### Neni 54

54.1. Nëse inspektori gjatë inspektimit zbulon parregullsi, kurse tregtia me shumicë e mallit të caktuar nuk ushtrohet në objekte përkatëse apo depo, ose malli i caktuar blihet në kundërshtim me kushtet e përcaktuara, me vendim, mund të ndalojë përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë tregtare deri në eliminimin e parregullive.

54.2. Ankesa në vendim nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

### Neni 55

55.1. Nëse inspektori gjatë inspektimit konstaton se:

- a. objektet e shitjes nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara minimale teknike dhe kushtet e tjera,
- b. nuk janë përmbushur kushtet për shitje jashtë objektit,
- c. nuk janë përmbushur kushtet e veçanta të pajisjes së shitores,

- d. nuk janë përmbushur kushtet e veçanta për mënyrën e shitjes së mallit,
- e. tregtari nuk mban evidencë për blerjen dhe shitjen, çmimin e mallit dhe shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar,

55.2. Me vendim tregtarit mund t'i ndalohet përkohësisht ushtrimi i veprimtarisë tregtare, deri në eliminimin e parregullsive të përcaktuara me inspektim,

55.3. Ankesa kundër vendimit nuk e ndalon ekzekutimin e tij.

#### Neni 56

56.1. Nëse inspektori i autorizuar konstaton se nga shitja e mallit të caktuar mund të shkaktohet dëm, rrezikim i shëndetit, jetës dhe mjedisit, me vendim mund të shqiptojë masën e ndalesës së shitjes së mallit të caktuar.

56.2. Ankesa në vendim nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

#### Neni 57

57.1. Nëse inspektori i autorizuar gjatë inspektimit konstaton që personi nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 38 ose tregtari nuk respekton orarin e përcaktuar të punës neni 40, me vendim:

- a. I ndalon vazhdimin e punës personit pa kualifikim përkatës profesional,
- b. I ndalon tregtarit afarizmin në kundërshtim me orarin e përcaktuar të punës.

57.2. Ankesa kundër vendimit nuk e ndalon ekzekutimin e tij.

#### Neni 58

1. Ankesa kunder vendimit të Inspektorit komunal sipas neneve 53, 54, 55, 56, 57 dhe 59 të këtij Ligji i drejtohet Inspektoratit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në afat prej 15 ditësh nga data e marrjes së vendimit nga inspektori.

2. Vendimi i Inspektoratit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë jepet brenda 60 ditëve nga data kur është pranuar ankesa, dhe i njëjti mund të apelohej pranë gjykatës përkatëse.

#### Dispozitat ndëshkuese

#### Neni 59

59.1. Gjjobitet në shumë prej 5.000 euro deri në 15.000 euro personi fizik apo juridik që:

- a). nuk i respekton kufizimet e vëna mbi ushtrimin e veprimtarive tregtare në nenet 42 dhe 43
- b). ushtron praktika të padrejta tregtare sipas neneve 47, 48, 49 dhe 50.

59.2. Për veprimet nga paragrafi 1, i këtij neni, gjjobitet për kundërvajtje edhe personi përgjegjës me gjorbë në shumë prej 500 deri në 1.500 €.

## Neni 60

60.1. Gjohitet në shumë prej 3.000 € deri në 9.000 € personi fizik apo juridik që:

- a. ushtron veprimtari tregtare për të cilat nuk është regjistruar sipas nenit 6,
- b. ushtron tregtinë me shumicë nën rrethana të paautorizuara sipas nenit 10,
- c. ushtron tregtinë me pakicë nën rrethana të paautorizuara sipas neneve 14 dhe 15,
- d. ushtron veprimtari tregtare pa leje të vlefshme apo në kundërshtim me nenin 16,
- e. zhvillon një ankand nën kushte që bien ndesh me kushtet e parashtruara në nenin 17,
- f. zhvillon veprimtari tregtare që nuk i përmbushin kushtet minimale teknike apo sanitare dhe shëndetësore, të cilat përcaktohen sipas nenit 38.1,
- g. i shkelë rregullat e caktuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë sipas nenit 38.2,
- h. ushtron afarizëm të caktuar tregtar pa i përmbushur kushtet minimale profesionale apo kualifikimet arsimore sipas nenit 39.1,
- i. nuk i mbanë librat dhe evidencën sipas nenit 41.

60.2. Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet edhe personi përgjegjës me gjobë prej 300 deri 900 €.

## Neni 61

61.1. Dënohet me gjobë prej 2.000 deri 6.000 € personi fizik dhe juridik, nëse shet mallra në ambient të hapur dhe nuk është i regjistruar, respektivisht nuk ka leje për ushtrimin e veprimtarisë së tregtisë ose për shitjen e mallrave, të cilët sipas dispozitave të veçanta nuk mund të shiten në ambient të hapur.

61.2. Dënohet prej 5.000 deri 15.000 € për kundërvajtje personi fizik ose juridik, i cili administron me ambientin e hapur nëse lejon shitjen e mallrave në këtë ambient pas paralajmërimit të inspektorit.

61.3. Dënohet me gjobë prej 1.000 deri 3.000 € personi fizik dhe juridik, nëse angazhon në punë punëtorë në shitje në kundërshtim me nenin 39.1

61.4. Dënohet me gjobë prej 1.000 deri 3.000 € personi fizik dhe juridik, nëse gjatë afarizmit nuk i përmbahet orarit të përcaktuar të punës neni 40.1.

61.5. Për veprimet nga paragrafi 1 deri 4 i këtij neni dënohet edhe personi përgjegjës me gjobë prej 200 deri 600 €.

## Neni 62

62.1. Për kundërvajtje nga neni 61.1, pika 1 dhe 2, i këtij Ligji, përveç gjobës shqiptohet edhe masa mbrojtëse e konfiskimit të fitimit të realizuar me kundërvajtjen e kryer dhe masa mbrojtëse e konfiskimit të sendeve, të cilat janë përdorur ose janë destinuar për kryerjen e kundërvajtjes ose kanë buruar nga kryerja e kundërvajtjes.

62.2. Për kundërvajtje nga neni 60 paragrafi 1 pikat: a, b, c, d, e, f, g, dhe h. të këtij Ligji përveç gjobës mund të shqiptohet edhe masa mbrojtëse e konfiskimit të sendeve që janë përdorur ose janë destinuar për kryerjen e kundërvajtjes ose kanë buruar nga kryerja e kundërvajtjes.

## Neni 63

63.1. Procedurën për kundërvajtje e udhëheq Gjykata Komunale për kundërvajtje në territorin e së cilës është kryer shkelja.

63.2. Procedurat, udhëheqja e së cilave nuk ka përfunduar, procesohen sipas dispozitave të cilat kanë qenë në fuqi deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## Neni 64

Të gjitha pagesat që rrjedhin nga aplikimi i dispozitave ndëshkuese të këtij ligji derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

## Dispozitat përfundimtare

### Neni 65

Aktet nga neni 8.2, 11.2, 14.1, 17.4, 38.1, 38.2, 39.2, 40 dhe 41.3 nxirren në afat prej një muaji nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

### Neni 66

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen dispozitat e ligjeve të zbatueshme që rregullojnë fushën e tregtisë së brendshme.

### Neni 67

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe shpalljes nga PSSP-ja.

**Ligji Nr.2004/18**  
**16 Qershor 2004**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës,**

**akademik Nexhat Daci**